

1 E premte, 15 dhjetor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.30

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjesi të gjithëve në
6 sallën e gjyqit dhe nga larg.

7 Znj. Sekretare e Gjykatës thërrisni rastin.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, i nderuar
9 Gjykatës.

10 Kjo është lënda KSC-BC-2023-11, Prokurori i Specializuar
11 kundër Haxhi SHALËS.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
13 Sekretare.

14 Tani u kërkoj palëve dhe pjesëmarrësve të prezantohen
15 duke filluar me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

16 Znj. Prokurore.

17 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Nga Zyra e
18 Prokurorit të Specializuar kemi Julie Mann Menaxhere e
19 çështjes; Josh Hafetz Prokuror; dhe unë Taz Shahabuddin.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mbrojtja, ju lutem.

21 Z. VAN PUYENBROECK: [Nuk ka përkthim]

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mund të bëj gabim duke
23 shqiptuar emrin tuaj, ju kërkoj ndjesë paraprakisht.

24 Si quhet?

25 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] Von, Von Broikuik [Sipas

1 përkthimit].

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po do të përpiqem ta
3 shqiptoj sa më mirë. Ju kërkoj ndjesë.

4 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] Pa merak.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani i drejtohem Zyrës
6 Administrative.

7 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëmëngjesi, z. Gjykatës. Z.
8 Nilsson, Përfaqësuesi i Zyrës Administrative sot.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Nilsson.

10 Për procesverbal konstatoj që z. Shala është i pranishëm
11 në sallën e gjyqit.

12 Unë jam Nicolas Guillou, Gjykatës i Procedurës Paraprake
13 në këtë lëndë.

14 Me 13 dhjetor programova Konferencën e parë për Ecurinë e
15 Lëndës për këtë të premtë. Qëllimi im sot është që të
16 shqyrtojmë gjendjen në të cilën gjendet lënda dhe të
17 organizojmë shkëmbimet mes palëve për të siguruar një
18 përgatitje sa më shpejtë për gjykim.

19 Në veçanti, dëshiroj të diskutojmë statusin, gjendjen e
20 hetimeve të Prokurorit të Specializuar; dëshmitë që priten dhe
21 sasinë e tyre, dëshmitë për gjykim; çështjet që lidhen dhe
22 zbulimin e materialeve mbështetëse për këtë aktakuzë, sipas
23 rregullës 102(1)(a); materialet shtesë që synohen të përdoren
24 në gjykim që nga rregulla 102(1)(b); materialet e provës të
25 Mbrojtjes, përgatitjes së Mbrojtjes të siguruar nga ato që

1 janë të të akuzuarit, sipas rregullës 102(3); provat
2 shfajësuese, nga rregulla 103; dhe materialet e mbrojtura nga
3 rregulla 107.

4 Gjithashtu do të diskutojmë procedurën e nxjerrjes së
5 materialeve, regjimin e redaktimeve që do të miratohet dhe do
6 të zbatohet në këtë procedurë, kërkesa e Prokurorit të
7 Specializuar për bashkimin e lëndëve, dhe çdo çështje tjetër
8 që palët dëshirojnë të parashtrojnë.

9 Falënderoj ZPS-në për parashtrimet e tyre. Konstatoj
10 gjithashtu që Urdhri për Programimin, për caktimin e datave
11 F00017 i është njoftuar Mbrojtjes në kohë dhe Mbrojtja nuk ka
12 patur mundësi që të paraqesë parashtrime me shkrim.

13 Ftoj palët që të paraqesin pikëpamjet e tyre në mënyrë të
14 përmbledhur për secilën pikë të gjendjes të cilën do ta
15 trajtojmë në mënyrë individuale.

16 Si zakonisht, u kujtoj palëve që të japin njoftim
17 paraprak në qoftë se kanë ndonjë parashtrim që kërkon -- që
18 përfshin zbulimin e informacioneve konfidenciale me qëllim që
19 të kalojmë në seancë private apo të mbyllur.

20 Së pari, të kaloj tek çështjet e përgjithshme. Përpara se
21 t'u jap fjalën palëve, ju rikujtoj atyre parimet e
22 përgjithshme të nxjerrjes së materialeve në kornizën ligjore
23 të Dhomave të Specializuara.

24 Nxjerrja e materialeve është një proces mes palëve që
25 bëhet në formë elektronike organizuar dhe lehtësuar përmes

1 sistemit të menaxhimit të Zyrës Administrative të Gjykatës.
2 Nxjerrja e materialeve do të jetë prioritet për Prokurorinë në
3 këtë fazë, dhe palët do të nxjerrin provat që kanë relevancë
4 të mirëfilltë për lëndën dhe jo në sasi të madhe.

5 Duke patur parasysh parim e publicitetit, provat
6 regjistrohen si publike përveç në rastet kur ka arsye për t'i
7 klasifikuar ndryshe. Pala që nxjerr materiale përcakton
8 nivelin e klasifikimit të duhur të materialeve provë, sipas
9 rastit.

10 Dua të dëgjoj fillimisht ZPS-në, qëndrimin e ZPS-në për
11 pikën e parë në agjendë; kryesisht nivelin, gjendjen e
12 hetimeve të tyre, lloji i provave që ato synojnë të paraqesin,
13 të përdorin në procedurë dhe sa dëshmitarë kanë -- synojë të
14 thërrasin në gjykim.

15 Znj. Prokurore.

16 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Lidhur me hetimin, ai është
17 në vazhdim, betimi është në betim e sipër [Sipas përkthimit]
18 megjithatë, presim që do të ketë vetëm disa hapa shtesë në
19 këtë fazë duke patur parasysh provat që tashmë i kemi,
20 vlerësimi jonë është që kjo do të na çojë në janar 2024.
21 Natyrisht, e them këtë me kushtin që duhet të marrim parasysh
22 në qoftë se dalin prova të reja dhe që të lejmë hapësirë për
23 këtë mundësi.

24 Sa i takon llojit të provave që ne synojmë të paraqesim
25 në gjykim kemi prova të dokumentuara materiale, të dhënat nga

1 thirrjet telefonike, të dhënat e telefonit, transkripte nga
2 deklarata të ndryshme, si dhe dëshmitarë.

3 Në parashtimin tonë me shkrim kemi paraqitur një listë
4 të këtyre provave që do të përbëjnë materialet nga rregulli
5 102(a).

6 Lidhur me numrin e dëshmitarëve, ZPS-ja është mbështetur
7 në deklaratat e dy dëshmitarëve lidhur me Aktakuzën e
8 Konfirmuar dhe synon që dëshmia e tyre të paraqitet në gjykim.
9 Kjo është lista e dëshmitarëve tanë aktualisht. Natyrisht ne
10 rezervojmë të drejtën të thërrasim dëshmitarë shtesë në qoftë
11 se kjo bëhet e nevojshme për autentifikimin e ndonjë prej
12 provave tona.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
14 Prokurore.

15 Tani i drejtohem Mbrojtjes.

16 A keni ndonjë parashtim për të bërë lidhur me këtë pikë
17 të përgjithshme të agjendës?

18 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] Faleminderit, z. Gjykatës.

19 Përpara që të bëj disa komente të përgjithshme lidhur me
20 nxjerrjen e materialeve, kam një pyetje për Gjykatën lidhur me
21 një çështje mundësisht që mund të jetë paraprake. Nuk e di
22 nëse është koha e përshtatshme tani apo në fund të seancës.
23 Dhe ka të bëjë deklarimin e z. Shala.

24 Siç e keni konstatuar në paraqitjen e tij të parë, ai nuk
25 është deklaruar mbi fajësinë apo pafajësinë e tij. Duke patur

1 parasysh informacionet shumë të kufizuara që i janë dhënë atij
2 deri në këtë moment, ai më ka transmetuar qëndrimin e tij të
3 qartë në këtë moment dhe dëshiron që ta shprehë këtë në
4 Gjykatë.

5 Nuk e di nëse është e mundur. E kuptoj që nuk është
6 çështje që lidhet me nxjerrjen e materialeve, por desha ta
7 nënvizoj dhe ta theksoj në këtë moment në kohë.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E keni fjalën që klienti
9 juaj synon që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë
10 e tij?

11 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] Thjeshtë që t'i jap --
12 dëshiron që të japë një deklaratë të përgjithshme lidhur me
13 deklarin e tij sipas rregullës.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Sepse unë e kisha në plan
15 të parashikohet, të programoja një seancë në janar lidhur me
16 deklarin e fajësisë, pas nxjerrjes së materialeve sipas
17 rregullës 102(a), pra, mund ta marrim deklaratën, ta pranojmë
18 deklarin e klientit tuaj edhe sot. Në fakt, nuk shoh ndonjë
19 problem të mundshëm, mund të pyes edhe palët e tjera cili
20 është qëndrimi i tyre lidhur me këtë. Ose mund të jap
21 mundësinë që këtë deklarin ta bëjë në mënyrë formale në janar.
22 Mund të marrim deklaratën e tij sot, jua le juve të vendosni.

23 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] Unë ja le vendimin
24 përfundimtar atij, pra të akuzuarit. Por, mesa kujtoj unë ai
25 dëshiron që të bëjë këtë deklaratë sot.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë, në një moment të
2 caktuar do të bëjmë një pushim, dhe pastaj do të vazhdojmë me
3 deklarin e klientit tuaj pasi që të kemi shqyrtuar pikën e
4 nxjerrjes së materialeve.

5 Nuk e di në qoftë se Prokuroria ka ndonjë qëndrim lidhur
6 me deklarin e akuzuarit.

7 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Prokuroria nuk e kundërshton
8 këtë.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë, vazhdojmë me
10 nxjerrjen e materialeve tani dhe në pjesën e dytë të
11 konferencës do të japim mundësinë e deklarimit.

12 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] Në qoftë se mund të bëjë
13 një deklaratë të përgjithshme lidhur me nxjerrjen e
14 materialeve.

15 Kam marrë datat e propozuara për nxjerrjen, të cilat
16 përputhen në përpikëri me rregullat e parashikuara. Por sipas
17 Mbrojtjes, kufizimi i tyre duket i justifikuar dhe i nevojshëm
18 me qëllim që Mbrojtja e Haxhi Shalës të jetë efektive.

19 Dhe pra, sa është e mundur në një afat kohor të shkurtër.

20 Nëse mund të jap një qartësim të shkurtër lidhur me këtë
21 kërkesë, Mbrojtja konstaton synimin tuaj që të veprojmë e të
22 ecim në mënyrë të shpejtë për të caktuar një datë gjykimi. Ne
23 e pranojmë këtë dhe jemi falënderues që kjo Konferencë për
24 Ecurinë e Lëndës është organizuar në një kohë kaq të shkurtër.

25 Në të njëjtën kohë ne shpresojmë që shkëmbimet që duhet

1 të ndodhin sot do të na mundësojnë nxjerrjen e materialeve në
2 mënyrë sa më shpejtë. Pra, nxjerrja e materialeve përpara
3 afatit kohor të parashikuar sipas rregullave, sipas Mbrojtjes
4 një afat kaq i shkurtuar dhe i shkurtuar është i arsyetuar dhe
5 i justifikuar.

6 Së pari, gjatë arrestimit të z. Haxhi Shala ka marrë --
7 atij i janë dhënë shumë pak informacione lidhur me
8 informacionet e sakta që kanë të bëjnë me krimet për të cilat
9 akuzohet. E kuptoj që kemi aktakuzën dhe vendimi për
10 konfirmimin e saj. Por të dyja janë shumë të rëndësishme,
11 mbështeten në materiale mbështetëse të cilat nuk janë zbuluar
12 deri tani.

13 Së dyti, një nxjerrje e materialeve e përshpejtuar është
14 shumë e rëndësishme për çështjen e paraburgimit, sepse një
15 nxjerrje e tillë do t'i japë mundësi Mbrojtjes që të bëjë një
16 kërkesë, një mocion lidhur me këtë.

17 Dhe përpara që të vlerësojmë paraqitjen e një kërkesë të
18 tillë, Mbrojtja ka nevojë që të shqyrtojë të gjitha materialet
19 relevante, dhe kjo dhe më tej nënvizon nevojën dhe rëndësinë e
20 nxjerrjes së materialeve në mënyrë të përshpejtuar.

21 Dhe së treti, kjo lëndë, siç e dëgjuam edhe nga Zyra e
22 Prokurorisë është e kufizuar në sasi, krahasuar me lëndë të
23 tjera, qoftë për numrin e dëshmitarëve që Prokuroria pritët të
24 thërrasë në Gjykatë, si edhe materialet mbështetëse.

25 Pra, për të përfunduar, z. Gjykatës, këto komentet e

1 përgjithshme, parashtroj se është -- pres që në këtë rrethana
2 Prokuroria të bëjë përpjekje të arsyeshme për të nxjerrë apo
3 për të përshpejtuar procesin e nxjerrjes e materialeve sa më
4 shumë që të jetë e mundur.

5 Ju falënderoj, z. Gjykatës, për marrjen parasysh të
6 këtyre komenteve në momentin e marrjes së vendimit të tyre
7 kornizë.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Avokat.

9 Znj. Prokurore, do të diskutojmë për secilin afat kohor
10 veçmas por a keni ndonjë koment për komentet e përgjithshme të
11 Mbrojtësit?

12 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Siç e kemi thënë
13 parashtrimin tonë me shkrim, Prokuroria ka propozuar një
14 kalendar shumë të shpejtë dhe ambicion për veten e vet. Ne
15 mendojmë që t'ju japim Mbrojtjes deri me datë 26 janar të
16 gjitha materialet nga rregulla 102(3) dhe siç e kemi thënë në
17 dosjen -- dhe parashtrimi, paraqitje e dosjes paraprake me
18 datë 2 shkurt.

19 Tani jemi -- kemi fazën e pushimit vjetor dhe kjo është
20 arsyeja për të cilën propozojmë që materialet nga rregulla
21 102(1) sipas rregullës afati për dorëzimin e këtyre të jetë 30
22 ditë deri në Paraqitjen e Parë që do të na çojë te data 11
23 janar.

24 Për aq sa të jetë e mundur, ZPS-ja do të dorëzojë
25 materialet, nxjerrë materialet paraprakisht me afate kohore të

1 ndryshme që ka propozuar më parë. Megjithatë, ne presim
2 Vendimin Kornizë sepse të gjitha materialet tona kërkojnë një,
3 qoftë edhe në mënyrë të kufizuar, disa redaktime duhet të
4 bëhen pra. Vendimi për masat mbrojtëse që ZPS-ja e ka [E
5 pakuptueshme] ZPS-ja e ka kërkuar, ka parashtruar kërkesë
6 lidhur me miratimin e masave mbrojtëse dhe protokollin që ka
7 të bëjë me kontaktin me dëshmitarët.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Kalojmë tek pika tjetër e
9 agjendës që janë materialet mbështetëse të aktakuzës.

10 Konstatoj që ZPS-ja synon të nxjerrë materialet nga
11 rregulla 102(1)(a) jo më vonë me 11 janar 2024. Gjithashtu
12 konstatoj se një pjesë e materialeve të ZPS-së sipas kësaj
13 rregulle mund të kërkojnë masa mbrojtëse.

14 Ftoj ZPS-në që të bëjë parashtrime shtesë lidhur me
15 nxjerrjen e kësaj kategorie të materialeve, në veçanti: Sasia
16 e përgjithshme, e tërësishme e këtyre e materialeve; nëse
17 përkthimet në gjuhën shqipe të deklaratave të dëshmitarëve
18 janë përfunduar dhe janë bërë; dhe nëse ZPS-ja synon që të
19 thërrasë në Gjykim këta dëshmitarë.

20 Dua të pyes tani ZPS-në nëse ka ndonjë mundësi që këto
21 materiale nga kjo kategori t'i nxjerrin më herët duke qenë se
22 këto janë materialet më të rëndësishme për Mbrojtjen në këtë
23 fazë; dhe gjithashtu pastaj ka ndikim kjo dhe në disa afate të
24 tjera kohore në qoftë se bëhet kjo nxjerrje e tillë, sidomos
25 mocionet paraprake që kanë ndikim në bashkimin e lëndës.

1 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Do filloj me volumin e
2 materialeve, që siç e kuptuat përmes komenteve të mia nuk
3 është volum i madh, = por, sa i përket materialeve nga
4 rregullave 102(1)(a), numri total i materialeve është 32. Dhe
5 këto janë dy deklarata dëshmitarësh, tre deklarata të marra
6 nga i akuzuari, si dhe disa raporte dhe materiale audio-
7 vizuale dhe dokumente të tjera.

8 Sa i takon afatit kohor, ka disa redaktime të kufizuara
9 por që duhet t'i bëjmë. Vendimi, për shembull, për masat
10 mbrojtëse do të na ndihmojë në nxjerrjen e materiale në mënyrë
11 të mëhershme. Por që jem e sigurtë me juve nuk e di sesa mund
12 ta shkurtojme këtë afat të propozuar të datës 11, duke patur
13 parasysh pushimin vjetor. Thënë këtë, ne do të bëjmë të gjitha
14 përpjekjet nga ana jonë që të vëmë në -- materialet për
15 dëshmitarët t'i nxjerrim në mënyrë sa më të shpejtë.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Shihni ndonjë mundësi që
17 t'i nxirrni materialet për të cilat nuk duhen -- të cilat nuk
18 kanë nevojë për redaktime, sepse e kuptoj që ka disa materiale
19 që kërkojnë një gjë të tillë.

20 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Natyrisht do të bëjmë
21 përpjekje në këtë drejtim. Kemi filluar -- fillojmë -- duke
22 filluar menjëherë nuk mund të angazhohem duke ju dhënë një
23 datë konkrete lidhur me këtë pikë duke patur parasysh pushimin
24 vjetor, edhe një herë, pra.

25 Gjëja tjetër që dua të përmend është që një pjesë --

1 provat kyçe të rëndësishme për Mbrojtjen që të fillojnë
2 shqyrtimin e imazheve forenzike nga telefoni që është
3 sekuestruar nga i akuzuari dhe telefonat e sekuestruar nga
4 bashkëkryesit e tij të identifikuar në Aktakuzën e Konfirmuar.
5 Këto materiale janë të -- në dispozicion të Mbrojtjes kurdo që
6 t'i marrin, duan t'i marrin në zyrën tonë.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
8 Prokurore.

9 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] Në veçanti duke patur --
10 konkretisht për materialet nga rregulla 102(1) Mbrojtja
11 thekson nevojën e një nxjerrjes të përshpejtuar. Ju e
12 parashtruat pyetjen që e kisha përgatitur, pra, që unë kisha
13 parashikuar që të bëja, domethënë, a është e mundur që kjo
14 nxjerrje të bëhet në mënyrë më të përshpejtuar.

15 Natyrisht i kuptoj ndikimet e pushimit vjetor. Rrethanë e
16 jashtëzakonshme, por gjithashtu është -- kjo është situatë --
17 edhe situata, gjendja në të cilën gjendet klienti im është
18 situatë, gjendje e jashtëzakonshme. Dhe kjo ka të bëjë
19 kryesisht me paraburgimin përpara daljes në gjykim.

20 Do të përpiqem të jem sa më i kuptueshëm nëse mund të
21 them lidhur me materialet e tjera. Por siç e theksuat edhe ju,
22 është pjesë thelbësore për Mbrojtjen që të fillojnë
23 përgatitjen e tyre, pra që këto materiale të nxirren në mënyrë
24 sa më të shpejtë. Unë propozoj që nxjerrja e materialeve do të
25 bëhet gradualisht sepse do ishte më mirë që këto materiale të

1 vazhdojnë që të jepen që përpara pushimit të dimrit. Ky është
2 thelbi i kërkesës sa i takon këtij materiali.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull. Pajtohemi.

4 Atëherë do të kërkoja që materiali të redaktohet sa më shpejt
5 që të jetë e mundur, të redaktohet jo më vonë sesa 11 janari,
6 por gradualisht duhet që të vazhdoni që të nxirrni materiale
7 në mënyrë të tillë që Mbrojtja të ketë mundësi që të bëjë
8 parashtrimet e veta në veçanti sa i takon mbajtjes në
9 paraburgim të të akuzuarit.

10 Tani le të kalojmë në materialin sipas rregullit
11 102(1)(b) që është materiali që synon që të përdoret në
12 gjykim.

13 Vërej se ZPS-ja propozon që të nxjerrë materiale shtesë
14 që janë në fushën e veprimit të rregullës 102(1)(b) dhe deri
15 me 19 janar, dhe në rastin më të vonë jo më vonë 30 ditë
16 përpara hapjes së lëndës së ZPS-së.

17 Ftoj ZPS-në që të japë parashtrime të tjera, të japë një
18 vlerësim të kohës që kur mendon që do t'i nxjerrë këto
19 materiale dhe hollësi të tjera që ZPS-ja dëshiron që t'i japë
20 lidhur me këto lloj dokumentesh apo materialesh.

21 Znj. Prokurore, fjala për ju. Ju lutem, ndizni
22 mikrofonin.

23 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
24 Gjykatës.

25 Volumi i materialeve sipas rregullës 102(1)(b), nenë këtë

1 kuadër, në këtë kontekst planifikojmë që të kemi 103 dokumente
2 që janë thuhajse 6.000 faqe dhe përbën mesatarisht 15 deklarata
3 dëshmitarësh. Këto konturet e përgjithshme ose kjo është
4 korniza e përgjithshme.

5 Ne planifikojmë që të nxjerrim sa i takon materialit
6 sipas rregullës 102(1)(a). Përsëri, materiali është material
7 shkresor, janë të dhënat të cilat janë nxjerrë nga telefonat
8 mobil, janë materiale audio-vizive, si dhe të dhëna të tjera.
9 Sikurse e përmenda edhe më herët kemi imazhet forenzike të
10 telefonave të të akuzuarve dhe bashkëkryesve të konfirmuar në
11 aktakuzën në kuadër të Çështjes 10.

12 Komentin shtesë që do të dua të jap tani për momentin
13 është që është e mundur që si rezultat i hetimeve në vazhdim
14 mund të duhet që të nxirren materiale të tjera më pas, sipas
15 rregullës 102(1)(b), dhe këto materiale mund të kërkojnë
16 gjithashtu edhe nevojën e përkthimit që ne propozojmë që ta
17 përfundojmë brenda afatit kohor që kemi propozuar.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

19 Prokurore.

20 Z. Van Puyenbroeck keni ndonjë parashtrim lidhur me këtë
21 pikë?

22 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] Nuk kam parashtrime të
23 tjera të hollësishme përveç parashtrimeve të përgjithshme që
24 ju thashë në fillim. Mbase një pikë që duhet të sqarohet pak
25 më tepër, nga Prokuroria u përmend deri tani dy herë aspekti i

1 hetimeve që vazhdojnë dhe ndoshta duhet që të bëhet e qartë që
2 këto hetime do të jenë të shkurtra por, do të doja që të
3 jepeshin pak më shumë hollësi lidhur me hetimet, sigurisht pa
4 u futur në hollësi.

5 E kuptoj që kjo është një çështje e cila lidhet me një
6 çështje tjetër 2023-10. Hetimet ka disa muaj që vijojnë lidhur
7 me këto çështje. Kam lexuar disa materiale procedurale të
8 lidhura me Çështjen 10. Në tetor 2023 parashikohej që hetimi
9 do të vazhdonte për tre muaj. Ndërkohë që tani ka kaluar ky
10 afat tremujor. Kështu që do të doja që Prokuroria, nëse është
11 e mundur, të na japë hollësi të tjera, pra të na japë një
12 informacion më të saktë sa i takon kuadrit dhe kohës kur
13 planifikon Prokuroria që do të përfundojnë hetime.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Avokat. Do
15 t'ja lë fjalën Prokurorisë që t'i përgjigjet pyetjes tuaj.
16 Megjithatë, sikurse e thatë Prokurore, ju nuk prisni që
17 hetimet të vazhdojmë përtej janarit, apo jo?

18 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Po, kjo është e saktë, i
19 nderuar Gjykatës. Sa i takon hapave shtesë që lidhen me
20 hetimin këto janë të kufizuara në natyrë dhe ka të bëjë me
21 hetime të të dhënave të telefonave të cilët ne i kemi në
22 posedimin tonë.

23 Sa i takon afatit, afati varet nga Gjykata. Megjithatë ne
24 do të mundohemi që të vazhdojmë sa më shpejt që të jetë e
25 mundur. Megjithatë, ajo çfarë dua të them në përgjigje të

1 pyetjes është që hetimi është i fokusuar, është i përqendruar,
2 kështu që nuk është se parashikojmë që të kemi ndonjë problem
3 sa i takon përfundimit të hetimeve në muajin e parë të vitit
4 që vjen.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull.

6 Le të kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, që lidhet
7 me materialin shkresor për përgatitjen e Mbrojtjes që është
8 materiali sipas 102(3).

9 Dëshiroj t'i kujtoj ZPS-së që nxjerrja ose inspektimi i
10 provave, si të tilla si deklarata, dokumente, fotografi ose
11 objekte të prekshme kanë rëndësi materiale për Mbrojtjen dhe
12 ato duhet që të nxirren pa vonesa të papërligjura. Njoftimi i
13 hollësishëm i një materiali të tillë duhet të përfshijë jo
14 vetëm informacionin e vlerësuar nga ZPS-ja si material
15 potencialisht i rëndësishëm për përgatitjen e Mbrojtjes, por
16 edhe si material dhe provë që në zotërim të ZPS-së që është
17 nxjerrë sipas rregullës 102(1)(a)(b), dhe 103, që ka rëndësi
18 për çështjen.

19 Ju kujtoj palëve që mosmarrëveshje sa i takon rëndësisë
20 materiale të informacionit siç pretendohet nga Mbrojtja duhet
21 që të dorëzohet menjëherë për t'u trajtuar nga Gjykatës i
22 Procedurës Paraprake.

23 Vërej se ZPS-ja parashikon që t'i japë Mbrojtjes një
24 listë të detajuar të materialit sipas njoftimit të rregullës
25 102(3) deri me 26 janar 2024.

1 Ftoj ZPS-në që të japë një vlerësim të llojit dhe sasisë
2 të informacionit, të redaktimeve që do të kërkohen si dhe
3 hollësi të tjera që dëshiron t'i japë ZPS-ja për këtë pikë të
4 rendit të ditës.

5 Fjala për ju Prokurore.

6 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Sa i takon materialit sipas
7 rregullës 102(3) ZPS-ja sigurisht që do të punojë në përputhje
8 me Rregulloren. Sa i takon natyrës së materialit ne aktualisht
9 vlerësojmë se materialet do të jenë më pak sesa 50 në numër
10 dhe se mundësisht ato do të përbëhen afërisht ose pak a shumë
11 nga 55 faqe materiale.

12 Ju kërkoj ndjesë. Ta them edhe një herë më saktë për
13 procesverbal këtë që sapo ceka. Ju kërkoj ndjesë, sa i takon
14 materialit 102(3) ajo çfarë për të cilën jam e përgatitur të
15 them është që ne kemi më pak sesa 50 materiale që janë
16 identifikuar deri tani. Megjithatë, shqyrtimi ynë vazhdon
17 kështu megjithatë, për momentin nuk mendojmë që ky material do
18 të jetë shumë herë më i madh se kaq sa përmenda.

19 Ajo çfarë kemi identifikuar ne nuk do të kërkojë
20 redaktime të tjera të mëtejshme kështu që parashikojmë
21 plotësisht që të respektojmë afatin që kemi propozuar sa i
22 takon këtij materiali.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

24 Prokurore.

25 Z. Avokat.

1 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] Nuk kam komente të tjera
2 për këtë pikë.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

4 Tani të kalojmë tek materialet sipas rregullës 103 që
5 është materiali shfajësues.

6 I kujtoj ZPS-së se ky material duhet që të nxirret
7 menjëherë për Mbrojtjen sapo ky material të jetë në kontroll
8 ose njohuri aktuale të Prokurorit të Specializuar dhe që mund
9 të sugjerojë në mënyrë arsyeshme që ceken pafajësia e të
10 akuzuarit ose lehtësojnë fajësinë e të akuzuarit ose
11 besueshmërinë dhe mbështetshmërinë e dëshmive të Prokurorit të
12 Specializuar.

13 Nxjerrja e materialit shfajësues është detyrim i
14 vazhdueshëm, me përjashtim të rasteve kur janë të nevojshme
15 masat mbrojtëse.

16 Vërej se ZPS-ja po vazhdon rishikimin e materialin sipas
17 rregullës 103. ZPS-ja thotë që mesatarisht 14 materiale janë
18 identifikuar të cilat janë përgatitur për nxjerrje të
19 menjëhershme.

20 Ftoj ZPS-në të na thonë sasinë dhe llojin e materialit
21 shfajësues për të cilin është në dijeni deri tani, në qoftë se
22 do të jenë të nevojshme redaktime të mëtejshme dhe hollësi të
23 tjera Prokuroria dëshiron që të japë lidhur me këtë pikë.

24 Fjala për ju Prokurore.

25 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Sikurse u përmend prej jush,

1 i nderuar Gjykatës, numri i materialeve që ka identifikuar
2 ZPS-ja që janë në fushën e veprimit të rregullit 103 janë 14.
3 Pra, janë 14 materiale gjithsej. Ne mendojmë që këto materiale
4 do të përfshijnë mesatarisht 55 faqe. Ndërmjet këtyre
5 materialeve janë deklarata ose raporte ose transkripte dhe
6 materiale të tjera audio-vizive. Janë materiale të cilat
7 përbëhen nga lloje të tjera dokumentesh shkresore që mund të
8 jenë shfaqësuese. Këto janë materiale që kërkojnë redaktime
9 dhe ne aktualisht po i përgatisim ato për t'ia nxjerrë
10 Mbrojtjes.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Avokat, keni ndonjë pyetje?

12 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të thënë
13 në lidhje me këtë çështje tani.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull.

15 Tani kalojmë te materiali i mbrojtur. Vërej aktualisht që
16 materiali që ZPS-ja synon ose duhet që të nxjerrë për
17 Mbrojtjen në përputhje me Rregulloren nuk kërkon vlerësimin
18 sipas rregullës 107, apo jo?

19 Prokurore, dëshironi të thoni ndonjë gjë lidhur me këtë?

20 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Vetëm kur identifikon
21 materialet që bien nën kufizimet e parashikuara në rregullën
22 107, vetëm atëherë mund të identifikojmë ekzaktësisht këtë
23 lloj materiali.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Keni ndonjë gjë për të
25 shtuar Avokat?

1 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] Jo.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani le të kalojmë te
3 procedura për nxjerrjen e materialeve dhe përdorimin e
4 kategorizimit konkret të rasteve që ngarkohen në sistemin
5 juridik të gjykatës në *Legal Workflow* për materialin sipas
6 rregullës 102(1)(a) dhe (b), dhe rregullës 104(1), (5) dhe (6)
7 dhe nxjerrjen e secilit grupeve materialesh.

8 ZPS-ja parashtron se mund të aplikojë nën kategori
9 specifike për çështjet në *Legal Workflow* sikurse jepet në
10 Urdhrin për Zhvillimin e Procesit dhe F00017 në paragrafin 21.

11 Në qoftë se Mbrojtja ka nevojë për më shumë sqarime
12 lidhur me këtë pikë, unë do t'i lexoj këto kategori nën
13 paragrafin 21 të Urdhrit F00017.

14 Nën kategoritë e sugjeruara nën këtë Urdhër janë: "Pika
15 1", "Pika 2", "Pika 3" nën kategorinë standarde të "veprave";
16 së dyti, "kryerja", "bashkëkryerja", "marrëveshja", "ndihma"
17 dhe "synimi/tentative" nën kategorinë e "sjelljes së
18 pretenduar të të akuzuarit; dhe së treti "Shala" nën
19 kategorinë standarde të të akuzuarit.

20 Znj. Prokurore, a keni ndonjë informacion tjetër konkret
21 apo jeni e kënaqur me këtë propozim?

22 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] ZPS-ja është tërësisht e
23 kënaqur me këto kategori të propozuara.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani le të kalojmë tek
25 Mbrojtja. Për t'i dhënë pak më shumë kontekst Mbrojtjes, këto

1 janë kategori të cilat synojnë që të ndihmojnë secilën prej
2 palëve dhe të kuptojnë menjëherë ose të kuptojnë natyrën e
3 provës materiale që ka rëndësi për aspektet përkatëse të
4 çështjes.

5 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
6 Gjykatës. Mbrojtja pajtohet me kategorizimin e propozimit.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Vërej që është arritur
8 pajtim midis palëve dhe në këtë kuptim do i nxjerr urdhrin e
9 parë me gojë.

10 Urdhëroj miratimin e nënkategorzimit specifik për
11 çështjen që duhet të aplikohet, zbatohet në *Legal Workflow*
12 sikurse specifikohet në Urdhrin F00017, në paragrafin 21.

13 Kjo përfundon urdhrin tim të parë me gojë.

14 Tani i ftoj palët të japin hollësi të tjera të mëtejshme
15 lidhur me pikat e mëposhtme. Në qoftë se palët mund të
16 pajtohen për një tabelë ose grafik të konsoliduar model për
17 nxjerrjen për përmbush kërkesat a rregullës 109(c) të
18 Rregullores; dhe në qoftë se ZPS-ja dhe Mbrojtja pajtohen që
19 t'i japin njëra-tjetrës një tabelë të konsoliduar të nxjerrjes
20 në kohën e parashtrimit të dosjes paraprake të ZPS-së dhe
21 dosjes paraprake të Mbrojtjes.

22 Znj. Prokurore, fjala për ju.

23 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] ZPS-ja pajtohet me
24 dispozitën e ndërsjellë të tabelës sipas rregullës 109(c) dhe
25 sikurse e kemi thënë në parashtrimet tona, këto tabela duhet

1 që të dorëzohen 15 ditë nga dorëzimi ose parashtrimi i dosjeve
2 paraprake në mënyrë që të shmangen gabimet e mundshme dhe të
3 jepen hollësitë e nevojshme për të dhënë të dhënat e nevojshme
4 si pjesë të kësaj tabele.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani më lejoni t'i jap
6 fjalën Mbrojtjes.

7 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] Faleminderit.

8 Mbrojtja është e shkurtër në këtë pikë. Ne pajtohemi me
9 procedurën e propozuar.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull.

11 Le të kalojmë në rendin tjetër të rendit të ditës që
12 është regjimi i redaktimeve. Në miratimin e regjimit të
13 redaktimeve është nevojshme që të sigurohet efikasiteti i
14 procesit të nxjerrjes duke gjetur një baraspeshë ndërmjet
15 detyrës për mbrojtjen e interesave të viktimave dhe
16 dëshmitarëve dhe respektimit të të drejtave të të akuzuarit.

17 Në parashtrimet e veta ZPS-ja pajtohet që të miratohet
18 regjimi i redaktimeve që është zbatuar në çështjen KSC-BC-
19 2023-10.

20 Ftoj ZPS-në dhe Mbrojtjen që të bëjnë parashtrimet e tyre
21 lidhur me këtë pikë.

22 Znj. Prokurore, fjala për ju.

23 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] ZPS-ja pajtohet me miratimin
24 e regjimit të redaktimeve të përdorur në çështjen 10.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

1 Z. Avokat.

2 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] Edhe Mbrojtja pajtohet me
3 këtë procedurë.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit Avokat.

5 Mbaj shënim marrëveshjen e palëve për këtë pikë.

6 Tani më lejoni t'i drejtohem çështjes së bashkimit të
7 çështjeve gjyqësore 11 dhe 10.

8 ZPS-ja ka dorëzuar një kërkesë për bashkimin e çështjes
9 11 dhe çështjes 10; përkatësisht Prokurori i Specializuar
10 kundër Sabit Januzit dhe Ismet Bahtijarit. Ky është
11 parashtrimi i protokolluar F00016. ZPS-ja ka dorëzuar një
12 kërkesë të tillë njësoj për çështjen 10, që është parashtrimi
13 i protokolluar F00132.

14 Si çështje paraprake, vërej se, në pajtim me Rregulloren
15 afati për Mbrojtjen për t'iu përgjigjur kërkesës për bashkimin
16 e çështjeve të ZPS-së takon në pushimin gjyqësor të dimrit të
17 Gjykatës që fillon të hënën me datë 18 dhjetor. Për pasojë si
18 në rastet e mëhershme unë synoj që të ndryshoj kalendarin për
19 të dhënë kohë të mjaftueshme për Mbrojtjen për të përgatitur
20 përgjigjen e vet.

21 Në këtë kuadër, dëshiroj të theksoj që gjatë Konferencës
22 së tretë për Ecurinë e Çështjes në Çështjen 10, udhëzova ZPS-
23 në që të dorëzonte një aktakuzë të propozuar të përbashkët për
24 Çështjen 10 dhe 11 si dhe një përshkrim të propozuar të
25 përbashkët sipas rregullës 86(3) që do të përfshinte

1 gjithashtu edhe nxjerrjen e materialit që qëndron në thelb të
2 aktakuzës së propozuar të përbashkët.

3 Përpara sesa të vazhdoj më tej, ftoj ZPS-në dhe Mbrojtjen
4 të bëjë parashtrimet e veta për sa i takon pra, dorëzimit të
5 aktakuzës së përditësuar në linjë apo në përputhje me atë
6 çfarë u vendos dje.

7 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Po, është e vërtetë që ZPS-
8 ja ka dorëzuar kërkesën për bashkimin e çështjeve në mundësinë
9 e parë të mundshme me synimin që të bëhet bashkimi i këtyre dy
10 çështjeve sa më shpejt që të jetë e mundur. Pra, ndërkohë
11 afati për nxjerrjen e materialeve është me 26 janar. Dhe
12 kuptimi këtu është që nxjerrja në këtë pikë të jetë bërë për
13 të dyja çështjet gjyqësore, të dyja lëndët me shpresën, pra,
14 prej 26 janarit e në vijim të mund të vazhdojmë në të njëjtin
15 ritëm për të dyja çështjet apo të mund të realizohet bashkimi
16 i çështjeve.

17 Sa i takon parashtrimin ose asaj çfarë u tha dje për
18 Çështjen 10 lidhur me dorëzimin e aktakuze të propozuar të
19 përbashkët, ZPS-ja thjeshtë dëshiron të thonë që ne do të
20 bëjmë parashtrimin e kësaj aktakuze të përbashkët në të
21 njëjtën kohë.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirë, faleminderit.

23 Z. Avokat, ndonjë gjë për të shtuar?

24 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] Jo, faleminderit nuk asgjë
25 për të shtuar.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani do të vazhdojmë
2 urdhrin e dytë me gojë.

3 Pasi kam dëgjuar palët, konstatoj të përshtatshme që të
4 urdhëroj ZPS-në që të dorëzojë një aktakuzë të përbashkët të
5 propozuar për Çështjet 11 dhe 10, sa i takon -- duke përfshirë
6 këtu edhe përmbledhjen sipas rregullit 86(3) dhe materialit
7 përkatës mbështetës.

8 Kërkoj që të ndryshohen gjithashtu edhe afatet e
9 parashikuara në rregull për t'iu përgjigjur kërkesës për
10 bashkim të çështjes së ZPS-së F00016.

11 Për rrjedhojë, urdhëroj ZPS-në që së pari të dorëzojë një
12 aktakuzë të përbashkët të propozuar për Çështjet 11 dhe 10
13 përfshirë dhe përmbledhjen sipas rregullës 86(3) dhe
14 materialit mbështetës jo më vonë sesa 12 janar 2024 në orën 4
15 pasdite.

16 Së dyti, Mbrojtjen e urdhëroj që t'i përgjigjet kërkesës
17 për bashkimin e çështjeve të ZPS-së, parashtrimi F00016, jo
18 vonë sesa 10 janar 2024 në orën 4 pasdite; dhe urdhëroj ZPS-në
19 që të kundërpërgjigjet jo më vonë sesa data 26 janar 2024 në
20 orën 4 pasdite.

21 Kjo përfundon urdhrin tim të dytë me gojë.

22 Përpara sesa të bëjmë një pushim prej 15 minutash në
23 mënyrë të tillë që i akuzuari të deklarohet për fajësinë apo
24 pafajësinë e tij, dua që t'ju kërkoj palëve në qoftë se kanë
25 ndonjë pikë tjetër që dëshirojnë të ngrenë në Konferencën e

1 sotme për Ecurinë e Çështjes.

2 Znj. Prokurore.

3 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të shtuar,
4 i nderuar Gjykatës.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Avokati.

6 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] As Mbrojtja nuk ka asgjë
7 për të shtuar.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zyra Administrative.

9 Z. NILSSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, na keni
10 kërkuar që të bëjmë disa parashtime lidhur me riklasifikimin e
11 disa dokumenteve. Dëshironi që ta bëjmë këtë gjë tani?

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po.

13 Z. NILSSON: [Përkthim] Zyra Administrative nuk
14 kundërshton klasifikimin, riklasifikimin ose ndryshimin e
15 klasifikimit të parashtimeve të mëposhtme nga konfidenciale
16 në publike, dhe këto janë: F00008, F00011, F00012.

17 Parashtroj më tej që Shtojca 1 e dokumentit F00012 duhet
18 të ruajë klasifikimin si konfidencial pasi përmban hollësi
19 personale të avokatit.

20 Sa i takon Shtojcës 1 të dokumentit F00011, Zyra
21 Administrative do të bëjë ndryshimin e versionit në version të
22 redaktuar publik të kësaj shtojce sa më shpejt të jetë e
23 mundur.

24 Sa i takon dokumentit F00011 ai është riklasifikuar si
25 publik.

1 Dhe së fundi, lidhur me dokumentin F00015 Zyra
2 Administrative nuk ka kundërshtim që raporti të ketë një
3 klasifikim, t'i ndryshohet klasifikimi nga konfidencial dhe
4 kjo mund të bëhet -- dhe mund t'i bëhet i disponueshëm
5 Mbrojtjes z. Shala, pra Mbrojtësit të caktuar kryesisht ose
6 kujdestar të z. Shala dhe do të dorëzojmë gjithashtu edhe
7 versionet konfidencial të redaktuara të Shtojcave 1, 2, 3 të
8 këtij parashtrimi të protokolluar.

9 Përveç kësaj, ne sa i takon dokumentit F00015 do të vëmë
10 në dispozicion një version të redaktuar publik të dokumentit
11 kryesor.

12 Faleminderit.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani do të bëjmë një pushim
14 prej 15 ose 20 minutash dhe do të vazhdojmë më tej me
15 deklarimin e fajësisë dhe pafajësisë të z. Shala.

16 --- Pauza fillon në orën 10.11

17 --- Seanca rifillon në orën 10.29

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Përpara se të kalojmë tek
19 deklarimi në lidhje me fajësinë ose pafajësinë, do të nxjerr
20 një urdhër në lidhje me parashtrimet që bëri përfaqësuesi i
21 Zyrës Administrative përpara pushimit.

22 Tani do të jap urdhrin e tretë gojor.

23 Pasi kam marrë parasysh kërkesën për riklasifikim të
24 Administratores urdhëroj reklasifikimin si publik të
25 parashtrimet të protokolluar F00008, F00011, pa shtojca, dhe

1 F00012 pa Shtojcën 1.

2 Gjithashtu urdhëroj riklasifikimin si konfidencial të
3 parashtrimit të protokolluar F00015 pa shtojcat dhe heq
4 shënimin *ex parte* nga ky parashtrim.

5 Me kaq përfundon urdhri im i tretë gojor.

6 Tani të kalojmë tek deklarami.

7 Z. Shala, gjatë seancës së paraqitjes së parë të
8 mërkurën, me 13 dhjetor, unë ju informova për nevojën që ju të
9 deklaroheni në lidhje me fajësinë ose pafajësinë për akuzat që
10 ju ngarkohen në Aktakuzën e Konfirmuar. Në ushtrimin e të
11 drejtës tuaj ju u deklaruat se nuk doni të deklaroheshit gjatë
12 seancës të Paraqitjes së Parë. Ju rikujtoj që në bazë të
13 rregullës 92 duhet të deklaroheni në lidhje me fajësinë apo
14 pafajësinë brenda 30 ditësh nga Paraqitja e Parë dhe në qoftë
15 se nuk e bëni këtë, unë si Gjykatës shënoj deklaramin e
16 pafajësisë në emrin tuaj.

17 Unë tani z. Shala do t'ju kërkoj që të deklaroheni fajtoj
18 ose i pafajshëm për secilën nga tre akuzat e përmbajtura në
19 Aktakuzën e Konfirmuar. Ju rikujtoj se ky është një vendim
20 mjaft i rëndësishëm.

21 Në qoftë se doni të deklaroheni fajtor për një ose për të
22 gjitha akuzat, procedura në lidhje me ato akuza do të shkojë
23 drejtpërdrejtë tek Trupi Gjykues. Nuk do të paraqiten prova
24 dhe nuk do të diskutohet fajësia apo pafajësia juaj. Trupi
25 Gjykues thjeshtë do të përcaktojë në qoftë se deklarami i

1 fajësisë është bërë në bazë vullnetare, do të bëhet me vullnet
2 të lirë dhe do të bëjë drejtcaktimin e dënimit.

3 Për ndryshe, në qoftë se, do të deklaroheni i pafajshëm
4 në lidhje me një apo të gjitha akuzat, atëherë procedura
5 paraprake do të vazhdojë në lidhje me të gjitha ato pikat e
6 akuzës në mënyrë që lënda të përgatitet për gjykim dhe t'i
7 dorëzohet Trupit Gjykues.

8 Gjatë gjykimit, atëherë, Trupi Gjykues do të dëgjojë
9 provat e paraqitura nga palët dhe do të marrë vendim në qoftë
10 se Prokuroria i ka provuar provat dhe fajësinë tuaj për ato
11 akuza.

12 Tani do t'ju pyes që të bëni deklarimin në lidhje me të
13 tre akuzat e përmbajtura në Aktakuzën e Konfirmuar. Këto tre
14 akuza iu lexuan gjatë Paraqitjes së Parë.

15 Z. Shala, përpara se të vetëdeklaroheni fajtor apo i
16 pafajshëm në lidhje me akuzat, a dëshironi që edhe një herë
17 t'ju lexohen këto akuza nga Sekretari i Gjykatës?

18 I AKUZUARI: Jo, i nderuar.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Shala.

20 Tani do t'ju pyes të deklaroheni. Si deklaroheni në
21 lidhje me Pikën 1, që ju ngarkon me veprën penale të pengimit
22 të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtareve përmes
23 kërcënimit të rëndë?

24 I AKUZUARI: Plotësisht i pafajshëm

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Si deklaroheni në lidhje me

1 Pikën 2, që ju ngarkon me veprën penale të pengimit të
2 personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes
3 pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi?

4 I AKUZUARI: Plotësisht i pafajshëm.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Si deklarojeni në lidhje me
6 Pikën 3, që ju ngarkon me veprën penale të frikësimit gjatë
7 procedurës penale?

8 I AKUZUARI: Njëjtë, plotësisht i pafajshëm.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Shala.
10 Mund të uleni.

11 Z. Shala, zgjodhët që të deklarojeni i pafajshëm në
12 lidhje me të gjitha pikat e akuzës, atëherë procedura
13 paraprake do të vazhdojë në mënyrë që lënda të përgatitet për
14 gjykim në përputhje me rregullën 95(3) të Rregullores.

15 Dua që t'i informoj palët se kam ndërmend që Konferencën
16 e ardhshme për Ecurinë e Çështjesh ta caktoj për javën e 5
17 shkurtit. Sa i përket mundësive për pjesëmarrje, ju kujtoj që
18 në qoftë se avokati i të akuzuarit do të marrë pjesë nëpërmjet
19 videokonferencës, duhet të bëjë një parashtrim me shkrim ose
20 nëpërmjet emailit 24 orë më parë, pra, Seancës përkatëse për
21 Ecurinë e Çështjes. Do të merrni urdhrin për caktimin e datës
22 me gjithë rendin e ditës për atë Konferencë.

23 I ftoj palët që në qoftë se duan të ngrenë çështje në
24 lidhje me pikat në atë Konferencë për këtë duhet të bëjnë
25 parashtrime me shkrim.

1 A keni diçka për të shtuar?

2 Znj. Prokurore.

3 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Jo, Prokuroria nuk ka asgjë
4 për të ngritur në këtë moment.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

6 Z. Van Puyenbroeck?

7 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës,
8 nuk kemi asgjë për të ngritur.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit

10 Z. Nilsson.

11 Z. NILSSON: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë për të ngritur.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

13 Me kaq përfundon seanca e sotme.

14 Falënderoj palët, Sekretarinë për praninë. Falënderoj si
15 zakonisht përkthyesit, teknikët audio-vizualë, stenografët dhe
16 personelin e sigurisë. Ju uroj festa të mira dhe të
17 shëndetshme dhe shihemi në vitin e ri.

18 --- Konferenca për Ecurinë e Çështjesh mbyllet
19 në orën 10.37

20

21

22

23

24

25